

UDHËZIM
Nr.4, datë 5.2.2010

PËR RISHPËRNDARJEN E KUOTAVE TË PAREALIZUARA DHE REGJISTRIMIN E PRANIMEVE PËR PLOTËSIMIN E KËTYRE KUOTAVE NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE, ME KOHË TË PJESSHME, E TË EDUKIMIT NË DISTANCË, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2009-2010

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr.1113, datë 13.11.2009, të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2009-2010”,

UDHËZOJ:

1. Të plotësohen kuotat e perealizura të shkronjës “a” të pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1113, datë 13.11.2009 “Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2009-2010”, pas përfundimit të regjistrimit të pranimeve në ciklin e parë të studimeve, me kohë të pjesshme, sipas udhëzimit nr.38, datë 25.11.2009 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2009-2010”.

2. Të rishpërndahen kuotat e perealizuara të pranimeve në ciklin e parë të studimeve me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2009-2010, sipas programeve të ndryshme të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, pasqyruar në tabelën nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin dhe të afishojnë listat e të gjithë aplikantëve, të renditura sipas rendit zbritës të pikëve të fituara, në përputhje me kriteret akademike të përcaktuara dhe të bëra publike paraprakisht, në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, brenda orës 12.00 të datës 9.2.2010, të ndara, sipas programeve të studimit përkatës. Në këto lista të jenë të evidentuar kandidatët fitues.

4. Regjistrimi i kandidatëve në programet e studimit me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, ku janë shpallur fitues të kryhet nga data 9.2.2010, ora 13.00 deri më 13.2.2010, ora 12.00, pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë.

5. Pas mbylljes së procesit të regjistrimit, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, në datën 17.2.2010, listat e kandidatëve fitues të regjistruar. Në lista të evidentohet dokumenti shkollor mbi të cilin është bërë regjistrimi.

6. Ngarkohen sekretari i përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe e Kërkimit Shkencor, institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

7. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

Tabela nr.1

TABELA PËR RISHPËRNDARJEN E KUOTAVE

Nr.	Programi i studimit	UT	UE	USH
		Shtesë	Shtesë	Shtesë

1	Histori			
2	Gjeografi			
3	Gjuhë-letërsi			
4	Biologji	16		
5	Punë sociale	1		
6	Psikologji	1		
7	Drejtësi	21		20
8	Administrim-biznes	10		3
9	Financë-kontabilitet	10		
10	Cikli i ulët parashkollor			
11	Cikli i ulët			
12	Gjuhë-letërsi			
13	Matematikë-fizikë			
14	Kimi-biologji			
15	Administrim-biznes		10	
16	Financë-kontabilitet		10	
17	Turizëm			
18	Histori-gjeografi			
19	Gjuhë-letërsi			
20	Menaxhim-agrobiznesi			
21	Agromjedis dhe ekologji			
22	Ekonomi dhe politika agrare			
	Totali	59	20	23